

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-14/01-06

Prishtinë, më 19 e 20 janar dhe 14 e 15 shkurt 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e drejtoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 88 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për inspektoratin shëndetësor,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për edukimin parashkollor,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për minierat dhe mineralet,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për metrologjinë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Radio Televizionin e Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës,
8. Raporti i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për familjen,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për konfliktet administrative,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër shpifjes dhe fyerjes.
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ditën e Dëshmorit,
13. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar ORA,
14. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e pavarur për ankesa,
15. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë për prokurim publik,
16. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e rregullatorit të energjisë,

17. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit ,
18. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për buxhet dhe financa lidhur me buxhetin e ART-së për vitin 2006,
19. Përgjigjja e ministres, Melihate Tërmkollli, lidhur me interpelancën e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe
20. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 9 shkurt 2006.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe rendin e ditës të kësaj seance.

Berat Luzha shtroi problemin e shembjes së gurëve në rrugën Prishtinë – Hani i Elezit, në Grykën e Kaçanikut. Ai propozoi që një grup i deputetëve menjëherë t'i bëjë një vizitë zyrtare pilot- njësisë komunale të Hanit të Elezit, komunës së Kaçanikut dhe rajonit të rrezikuar.

Kuvendi t'i rekomandoj Qeverisë të shkojë në këtë rajon të rrezikuar dhe ta përcjellë gjendjen nga afër dhe të aftësohet menjëherë një kalim alternativ për popullatën e kësaj ane.

Xhavit Haliti ngrehu shqetësimin për vrasjet e shumta që po ndodhin në Kosovë, të cilat nuk po zbulohen nga organet përkatëse. Ai përmendi rastet e fundit kur pjesëtarët e SHPK-së kishin vrarë një qytetar në Pejë dhe një në Vushtrri – janë të pajustificueshme. Përgjegjësit e fushës së sigurisë duhet të japin llogari për këto vrasje.

Ferid Agani, në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, propozoi që rendit të ditës të kësaj seance t'i shtohet edhe një pikë – debati lidhur me përgatitjet e Grupit Negociator për bisedimet në takimin e Vjenës, për çështjen e decentralizimit.

Teutë Sahatçia, në emër të Grupit Parlamentar ORA, tha se e mbështetë kërkesën e Berat Luzhës, si dhe kërkesa e tyre për seancë të jashtëzakonshme lidhur me mocionin e parashtruar, të mbahet sot, si pikë e parë e rendit të ditës.

Hydajet Hyseni shtroi çështjen e pyetjeve parlamentare, për të cilat Kuvendi duhet të merret qëndrim, që në mbledhjen vijuese të rezervohet një pikë e veçantë për pyetjet e deputetëve. Ai kishte parashtruar dy pyetje parlamentare Qeverisë, para 3-4 muajve, por nuk kishte marrë asnjë përgjigje.

Gjelnaze Sylja tha se seancat plenare duhet të fillojnë me një përmbledhjeve të ngjarjeve, që kanë ndodhur ndërmjet dy seancave.

Kryetari e hodhi në votë kërkesën e Grupit Parlamentar ORA. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----35. Të pranishëm ishin 98 deputetë.

Kryetari konstatoi: Kuvendi nuk e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar ORA, që mocioni i tyre të jetë pikë e parë e rendit të ditës së kësaj seance.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverballi i seancës së mëparshme u miratua me vërejtjen e deputetit **Hajredin Hyseni**, ngase ishte bërë lëshim në transkriptin e seancës së mëparshme, në faqën 175 ishte evidencuar emri i tij si diskutues lidhur me formimin e Komisionit për siguri, e në fakt kishte diskutuar, për këtë temë, deputeti **Xhevat Bislimi**.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për inspektoratin shëndetësor

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 94.

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, njëzëri **miratoi** Ligjin për inspektoratin shëndetësor.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për edukimin parashkollor

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10 dhe 11.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 94.

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, njëzëri **miratoi** Ligjin për edukimin parashkollor.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për minierat dhe mineralet

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1(b) 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10,11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44 dhe 45.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 94.

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, njëzëri **miratoi** Ligjin për minierat dhe mineralet.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për metrologjinë

Afrim Arzuallxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kërkoi që projektligj të tërhiqet nga procedura.

Fatmir Rexhepi, në emër të Komisionit FunkSIONAL, i arsyetoi amendamentet e propozuara dhe kërkoi që të procedohet me miratimin e tyre.

Ministri **Bujar Dugolli**, në emër të Qeverisë së Kosovës- propozuesit të Projektligjit- tha se i mbështet amendamentet e Komisionit funksional.

Kryetari i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1(a), 2, 3(a), 4, 5(a), 6, 7, 8, 9,10,11, 12, 13, 14, 15, 16(a) dhe 17.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 71,

Kundër----- 13.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash, **miratoi** Ligjin për metrologjinë.

Kryetari dha pauzë për drekë.

Pas pauzës, seancën e kryesoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Për shkaqe të mos funksionimit të teknikës së përkthimit, kryesuesi i mbylli punimet e seancës së sotme, për t'i vazhduar të nesërmen në orën 10.00.

Më 20 janar 2006
Vazhdim i seancës

Të pranishëm ishin 83 deputetë.

Seancën e kryesoi **Nexhat DACI**, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Radio Televizionin e Kosovës

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9,10,11, 12, 13, 14, 15, 16, 17(b), 18(a), 20, 22(b), 23, 24, 26, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32.

Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente: 5, 19, 21 dhe 25.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 73.

Kundër----- 4.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash, **miratoi** Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4,5, 6, 7, 8, 9(a),10,11(a), 12, 13, 14(a) dhe 16.

Kuvendi nuk e miratoi amendamenti e 15-të.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 79.

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash, **miratoi** Ligjin për provimin e jurisprudencës.

8. Shqyrtimi i raportit i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për familjen

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të këtij ligji. Por, PSSP-ja nuk e kishte shpallur këtë ligj, ngase Zyra ligjore e tij kishte bërë disa vërejtje, të cilat ia kishte dërguar Kuvendit për shqyrtimit.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese i kishte shqyrtuar vërejtjet e Zyrës ligjore të UNMIK-ut, të cilat i kishte miratuar dhe Kuvendit i kishte propozuar amendamentet për miratim.

Deputetja **Nerxhivane Dauti** paraqiti raportin e Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me amendamentet e propozuara në Ligjin për familjen.

Ajo kërkoi që amendamentet e propozuara të votohen në paketë.

Nazim Jashari kërkoi që amendamentet nga Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese në Ligjin për familjen të votohen, një nga një.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e përfaqësuesit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, Nerxhivane Dauti.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----64,

Kundër----- 13.

Kryetari i hodhi në votë amendamentet e Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese 1 – 49, në tërësi në Ligjin për familjen.

Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për-----63,

Kundër----- 5.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi amendamentet e propozuara nga Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese në Ligjin për familjen.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri Bajram Kosumi, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, kryeministri **Kosumi** shpjegoi materien, objektivat, mënyrën e realizimit, efektet buxhetore, si dhe faktorët kryesorë për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga kryeministri **Kosumi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ramadan Kelmendi, Nerxhivane Dauti, Mazllun Kumnova, Hysnija Beshkoviq, Nexhat Rexha, dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 69;
Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për ndërmjetësim.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Cështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

Kuvendi mbajti një minut heshtje në shenjë nderimi për ushtarët e KFOR-it, të kontigjentit hungarez, që kishin humbur jetën në fatkeqësi të komunikacionit ajror, të cilët pasi kishin shërbyer në Kosovë, ishin duke u kthyer në vendin e tyre.

Pas kësaj kohe seancën e kryesoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për konfliktet administrative

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja Melihate Tërmkoli, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, ministrja **Tërmkoli** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga , ministrja **Tërmkoli**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Sadudin Berisha, Nerxhivane Dauti, Ymer Halimi, Shpresa Murati, Milazim Haliti dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 65;
Kundër----- 2.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për konfliktet administrative.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër shpifjes dhe fyerjes

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri **Bajram Kosumi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim kryeministri **Kosumi**, shpjegoi materien, strukturën, objektivat, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga kryeministri **Kosumi**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Hydajet Hyseni, Nekibe Kelmendi, Gani Koci, Zylfije Hundozi, Nazim Jashari, Xhezair Murati, Fetah Berisha, Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Fatmir Sejdiu dhe Fatmir Rexhepi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 51;

Kundër----- 8;

Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin kundër shpifjes dhe fyerjes.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Cështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ditën e Dëshmorëve

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri **Bajram Kosumi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim kryeministri **Kosumi**, shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga kryeministri **Kosumi**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fatmir Sejdiu, Xhevat Bislimi, Gjylnaze Syla, Fatmire Mulhaxha, Mahir Jakhillar, Gjergj Dedaj, Hydajet Hyseni, Kamber Kamberi, Nazim Jashari, Sadudin Berisha, sabri Hamiti dhe Jakup Krasniqi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Kryeministri Bajram Kosumi iu përgjigj pyetjeve dhe vërejtjeve të deputetëve lidhur me këtë projektligj.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 73;

Kundër----- 2,

Abstenime----- 5.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për Ditën e Dëshmorëve.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Cështje Gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim.

Kryesuesi e deklaroi seancën sotme të mbyllur në orën 16:15 minuta.

Shënim: vazhdimi i seancës ishte shtyer për shkak të vdekjes së kryetarit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova.

Më 14 shkurt 2006

Vazhdim i seancës

13. Debat sipas kërkesës së Grupi Parlamentar ORA

Teutë Sahatçiu, në emër të Grupit Parlamentar ORA, kërkoi që debati sotëm të zhvillohet në dy pika: a) për mënyrën e vendimmarrjes për ndërtimin e Qendrës administrative-protokollare dhe b) për shpenzimet buxhetore të Kuvendit të Kosovës për periudhën janar - qershor 2005.

Gazmend Muhaxheri, para deputetëve të Kuvendit paraqiti mocionin e Grupit Parlamentar ORA lidhur me mënyrën e vendimmarrjes për ndërtimin e Qendrës administrative-protokollare në Gërmi, i cili e kontestoi ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje.

Isuf Demaj, sekretar i Kuvendit të Kosovës, arsyetoi procedurat e vendimmarrjes dhe të tenderimit për ndërtimin e Qendrës administrative-protokollare në Gërmi, si dhe mohoi konstatimet e Grupit Parlamentar ORA lidhur me këtë çështje.

Deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe të ORA-s, në shenjë pakënaqësie që sekretari i Kuvendit iu drejtua deputetëve, e lëshuan seancën.

Pastaj, kryetari e hapi debatin lidhur me mocionin e ORA-s.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë çështje dhanë edhe këta deputetë: **Fadil Geci, Jakup, Krasniqi, Gjylnaze Syla, Besa Gaxheri, Lulzim Zeneli, Xhavit Haliti, Ramadan Kelmendi, Fatmire Kollçaku, Mark Krasniqi, Sanije Aliaj, Ferid Agani, Hydajet Hyseni, Nazim Jashari, Nimon Alimusaj, Veton surroi, Gani Koci, Behxhet Brashori, Nekibe Kelmendi, Alush Gashi, Genc Gorani, Fetah Berisha, Gjergj Dedaj, Ylber Hysa, Xhevat Bislimi, Ymer Halimi dhe Sabri Hamiti**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi tha se janë dy propozime:

- a) Grupi Parlamentar i LDK-së propozon që Kryesia e Kuvendit t'i shqyrtojë të gjitha çështjet e ngritura nga Grupi Parlamentar Ora dhe Kuvendit t'ia paraqes një raport lidhur me të;
- b) Grupi Parlamentar i PDK-së dhe i ORA-s propozojnë të formohet një Komision hetimor parlamentar, për t'i vërtetuar faktet lidhur me çështjet e ngritura nga Grupi parlamentar Ora.

Kryesuesi e hodhi në votë propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----46;

Kundër-----23.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi, me shumicë votash, miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kuvendi e ngarkoi Kryesinë e Kuvendit që në bazë të debatit t'i vërtetoi faktet lidhur me çështjet e ngritura nga Grupi Parlamentar i ORA-s dhe Kuvendit t'ia paraqes një raport lidhur me të.

Deputeti Sabit Rrahmani kërkoi nga Kuvendit që t'ia ndaj 3.200€, për të shënuar Ditën e Ashkalinjëve.

Kuvendi e miratoi kërkesën e deputetit Rrahmani.

Kryesuesi e deklaroi seancën e sotme të mbyllur në orën 16:15 minuta.

Më 15 shkurt 2006

Vazhdim i seancës

Të pranishëm ishin 80 deputetë.

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kurse i ndihmoi Naim **MALOKU**.

14. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e pavarur për ankesa

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me propozimin Qeverisë së Kosovës.

Ministri Haki **Shatri** e arsyetoi propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e pavarur për ankesa.

Deputeti Gani Koci kërkoi sqarime nga Qeveria e Kosovës për ndryshimin e listës së propozuar më herët me atë të tanishmen.

Ministri Haki Shatri sqaroi ndryshimet e bëra në propozimin e fundit.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e pavarur për ankesa. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----51;

Kundër----- 30;

Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur të Ankesave

I. Në Bordin e Pavarur të Ankesave emërohen këta kandidatë:

1. Lutfi Zharku, kryetar, me mandat dyvjeçar,
2. Muharrem Ibraj, anëtar, me mandat dyvjeçar,
3. Mentor Prekazi, anëtar, me mandat dyvjeçar,
4. Azem Shefkiu, anëtar, me mandat dyvjeçar,
5. Shaban Muharremi, anëtar, me mandat dyvjeçar,
6. Nevruz Berisha, anëtar, me mandat dyvjeçar,
7. Minire Begaj, anëtar, me mandat dyvjeçar,
8. Bahri Hyseni, anëtar, me mandat njëvjeçar,
9. Hajdin Ramadani, anëtar, me mandat njëvjeçar,
10. Islam Çeku, anëtar, me mandat njëvjeçar,
11. Zijadin Maliqi, anëtar, me mandat njëvjeçar,
12. Qemajl Smajli, anëtar, me mandat njëvjeçar dhe
13. Lubisha Shipiq, anëtar, me mandat njëvjeçar.

15. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë për prokurim publik

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me propozimin Qeverisë së Kosovës.

Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pati vërejtjet për kandidatin e propozuar Behxhet Rukiqi, ngase nuk e ka mbaruar fakultetin.

Pas diskutimeve të deputetëve: **Gani Koci, Xhavit Haliti, Jakup Krasniqi, Alush Gashi, Behxhet Brashori she të ministrit Haki Shatri**, që i janë bashkangjitur stenogramit, kryetari e hodhi në votë propozimin e Qeverisë së Kosovës.

Rezultati ishte si vijon:

Për-----53;

Kundër-----28;

Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Prokurimit Publik

I. Në Bordin e Agjencisë së Prokurimit Publik emërohen këta kandidatë:

1. Vlora Kuçi, kryetare,
2. Sami Uka, anëtar,
3. Sadik Deliu, anëtar dhe
4. Sabri Ramadani, anëtar.

II. Anëtari i pestë do të emërohet pas marrjes së propozimit të ri nga Qeveria e Kosovës.

III. Mandati i anëtarëve të Bordit së Agjencisë për Prokurimit Publik zgjat dy (2) vite.

16. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e rregullatorit të energjisë

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me propozimin Qeverisë së Kosovës.

Ai e hodhi në votë propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e rregullatorit të energjisë. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----59;

Kundër----- 19;

Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Rregullatorit të Energjisë

I. Në Bordin e Rregullatorit të Energjisë emërohen këta kandidatë:

1. Theranda Beqiri, ligjëruese në Shkollën e Biznesit, në Pejë.
2. Nusret Avdiu, profesor në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, në Prishtinë

17. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me propozimin Qeverisë së Kosovës, si dhe me propozimet e grupeve parlamentare.

Jakup Krasniqi, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së tha se grupet parlamentare nuk janë takuar për t'i harmonizuar qëndrimet lidhur me propozimet për emërimin e anëtarëve në Agjencinë kundër korrupsionit.

Ai propozoi që anëtarët e Agjencinë kundër korrupsionit, nga Kuvendi, të jenë nga opozita.

Kryetari dha pauzë gjysmë orësh, gjatë së cilës kryetarët e grupeve parlamentare duhej t'i harmonizonin qëndrimet dhe Kuvendit t'ia paraqesin kandidatët për anëtar të Agjencisë kundër korrupsionit.

Pas pauzës, **Alush Gashi**, kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, i informoi deputetët lidhur me qëndrimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Ata kërkojnë që emërimi i anëtarëve në Agjencinë kundër korrupsionit të shtyhet për seancën e radhës, për t'u dhënë kohë që shihen përvojat e shteteve tjera se si e kanë të rregulluar këtë çështje.

Kryetari konstatoi: Kuvendi e mbështetë propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare që emërimi i anëtarëve të Agjencisë kundër korrupsionit të shtyhet për seancën e radhës.

18. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për buxhet dhe financa lidhur me buxhetin e ART-së për vitin 2006

Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, e arsyetoi buxhetin e ART-së për vitin 2006.

Pas diskutimeve të deputetëve: **Nazim Jashari, Safete Hadërgjonaj, Xhavit Haliti, Zef Morina, dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur stenogramit, kryetari e hodhi në votë. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----53;

Kundër----- 31;

Abstenime---- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash mori

V E N D I M

Për miratimin e buxhetit të ART-së për vitin 2006

1. Shuma e buxhetit të ART-së për vitin 2006 është 794.254,80€.
2. ART-ja për shpenzimet e buxhetit të këtij viti, si dhe të vitit paraprak duhet t'i paraqes raport Kuvendit, për mënyrën e shpenzimit të tij.

19. Përgjigjja e ministres, Melihate Tërmkollit, lidhur me interpelancën e Grupit Parlamentar të PDK-së

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për përgjigjen e ministres, Melihate Tërmkollit, në interpelancën e kërkuar nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

Deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së: **Ramë Buja, Xhevat Bislimi dhe Xhavit Haliti** thanë se duhet të respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit që ministrat e Qeverisë së Kosovës t'i përgjigjen ftesës për interpelancë parlamentare.

Kryetari tha se me kalendarin e ri për mbajtjen e seancave plenare do të sigurohet një termin prej një orësh, në javën e fundit të muajit, që ministrat e Qeverisë së Kosovës t'u përgjigjen pyetjeve të deputetëve.

20. Propozimi i rendit të ditës për seancën e radhës

Me propozimin e Kryesisë, Kuvendi e miratoi rendin e ditës për seancën plenare më 23 shkurt 2006.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 12:15 minuta.

E hartoi

Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik **Nexhat DACI**

